REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr 540 Prot Lushnje 14 / 01 /2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK

PËR DHËNIE E AUTORIZIMIT PËR RINOVIMIN E KONTRATËS SË QIRASË

Të nderuar Zonja dhe Zotërinjë Këshilltarë!

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore " e konkretisht në nenin 23 "Funksionet e Bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike" theksohet se Bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre pika 10 e nenit për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake. Bashkia Lushnje shërbimin e grumbullimit të transportit të mbetjeve e ka kryer sipas kontratës me nr.423 prot. datë 15.01.2025 në Impiantin e Trajtimit të Mbetjeve Fier, Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërvendorë "Për menaxhimin e Landfillit (depozitim, peshim, pastrim dhe mirëmbajtje e rrugës hyrëse) në Impiantin e mbetjeve Urbane të Qarkut Fier", protokolluar në Bashkinë Lushnje me nr.423 prot. datë 15.01.2025. Impiantin e Trajtimit të Mbetjeve Fier e menaxhon Ndërrmarrja e Pastrimit Bashkia Fier. Nga ana e kësaj Ndërrmarrje me shkresën me nr.903 datë 16.12.2025 duke qënë se Bashkia Lushnje është pjesë e kontratës së lidhur, është kërkuar dhenia e dakortësisë sipas kontratës së qirasë me nr.423 prot. datë 15.01.2025 nësë jemi dakort për rinovimin e kontratës me të njejta kushte me Marrëveshjen e bashkëpunimit ndërvendorë " Për menaxhimin e Landfillit (depozitim, peshim, pastrim dhe mirëmbajtje e rrugës hyrëse) në Impiantin e mbetjeve Urbane të Qarkut Fier". Në këto kushte është e domosdoshme dhënia e autorizimit për Kryetarin e Bashkisë Lushnje për rilidhjen e kontratës së qirasë, për pjesën takuese të Bashkisë Lushnje. Zhvillimin e negociatave me Bashkitë përbërëse të Qarkut Fier, të cilat depozitojnë mbetje urbane në Landfillin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier,për rilidhjen e marrveshjes së bashkëpunimit dhe përcaktimit të një strukture të përbashkët, e cila do të kryejë për llogari të gjithë Bashkive të Qarkut Fier, menaxhimin e pjesës së depozitimit, të peshimit dhe rrugën hyrëse në Impiantin e mbetjeve Urbane të Qarkut Fier .

Duke ju falenderuar për mirëkutimin!

KRYETARI I BASHKISË

ERISELDA SEFA

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr 540/11 Prot

Lushnje 14 / 01 /2026

PROJEKT-VENDIM

Nr.05 Datë 14 / 01/2026

PËR DHËNIE E AUTORIZIMIT PËR RINOVIMIN E KONTRATËS SË QIRASË

Këshilli Bashkiak Lushnje,në mbledhjen e datës ____/_____/2026, bazuar në nenet 3,8,9,14,23,32,54 shkronja "gj" neni 55 pika 3 të Ligjit nr.139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore " i ndryshuar. Ligjit nr.68 datë 27.04.2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " .Ligjit 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë." Udhëzimit nr.9 datë 20.03.2018 " Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit ". Kërkesës me nr.903 prort datë 16.12.2025 të Ndërmmarrjes së Pastrimit dhe Higjenës, Bashkia Fier, për dhënien e dakortësisë për rinovimin e kontratës së qirasë me objekt përdorimi " Menaxhim vetëm i rrugës hyrëse,peshores dhe vend-depozitimit (Landfilldit) të mbetjeve urbane, në Impiantin e Trajtimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier " Ju:

PROPOZOJMË :

1. Dhënie e autorizimit për Kryetarin e Bashkisë për rinovimin e kontratës së qirasë me të njëjtat kushte me Kontratën e qirasë me nr.423 prot. datë 15.01.2025 dhe Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërvendorë " Për menaxhimin e Landfillit (depozitim, peshim, pastrim dhe mirëmbatje e rrugës hyrëse) në Impiantin e Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier ".

2. Për zbatimin e kontarës ngarkohet Ndërmarrja e Pasurisë Publike Bashkia Lushnje.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpallijes.

DREJTORIA JURIDIKE

Bedri Hida

NDËRMARRJA E PASURISË PUBLIKE

Elson Zeka

KRYETARI I BASHKISË

ERISELDA SEFA

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com